



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/29
Datë: 17.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, nenit 12, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pa kompensim të pronave të menaxhuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës, përkatësisht të ngastrave kadastrale të përcaktuara në Shtojcën 1. të këtij Vendimi, për nevojat e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit KRU "Mitrovica" Sh. A., me qëllim të realizimit të projektit për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm për Komunën e Leposaviqit.
2. Përfitues i të drejtës së shfrytëzimit afatgjatë të ngastrave kadastrale, me të dhënat e detajuara dhe të paraqitura në Shtojcën 1. të këtij Vendimi, është KRU "Mitrovica".
3. Ngastrat me të dhënat e paraqitura në pajtim me Kërkesën e KRU "Mitrovica" regjistrohen si shfrytëzues KRU "Mitrovica".
4. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia Pyjore e Kosovës, dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimet Hapësinor për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të kompetencave të saj për administrimin e pronave të menaxhuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës, ka pranuar Kërkesën e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Mitrovica" Sh. A., me nr. prot. 1021, të datës 25.05.2026, për sigurimin e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës për realizimin e projektit të furnizimit me ujë të pijshëm për Komunën e Leposaviqit.

Projekti paraqet investim me interes të rëndësishëm publik, pasi synon përmirësimin e sigurisë së furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Leposaviqit, si dhe avancimin e infrastrukturës publike në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore të sigurta dhe të qëndrueshme.

Për realizimin e projektit janë identifikuar këto ngastra kadastrale, të vendosura në zonën kadastrale Kutnje, të cilat administrohen nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

Sipas projektit ideor, parashihet hapja e dy bunarëve, ndërtimi i stacionit të pompimit dhe i infrastrukturës përcjellëse për transportimin e ujit të papërpunuar, deri në Fabrikën e Ujit në Leposaviq.


Në funksion të realizimit të këtij projekti, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i është drejtuar Agjencisë Pyjore të Kosovës, me Kërkesë për dhënien e pëlqimit paraprak për shfrytëzimin e ngastrave të identifikuara, si dhe për ofrimin e informatave lidhur me procedurat, kushtet, dokumentacionin dhe autorizimet e nevojshme për sigurimin e së drejtës së shfrytëzimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me Shkresën nr. 1228, të datës 26.06.2026, Agjencia Pyjore e Kosovës ka njoftuar Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se ngastrat e lartcekura janë të lira nga çdo barrë juridike, nuk janë objekt i ndonjë kontrate të vlefshme, nuk janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm dhe nuk ekziston ndonjë planifikim, apo angazhim i paraparë për to, në të ardhmen.

Në të njëjtën Shkresë, Agjencia Pyjore e Kosovës ka theksuar se, bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, pjesa e pyllit dhe e tokës pyjore në pronësi të Republikës së Kosovës mund të jepet në shfrytëzim për nevoja të projekteve strategjike zhvillimore, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa në raste të veçanta që paraqesin interes të veçantë dhe nevojë të shtetit, e drejta e shfrytëzimit mund të jepet pa kompensim.

Duke marrë parasysh rëndësinë publike të projektit, faktin se ngastrat e identifikuar janë pronë e Republikës së Kosovës dhe janë të lira nga çdo pengesë juridike për shfrytëzim, si dhe bazën ligjore të përcaktuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, propozohet që Qeveria e Republikës së Kosovës ta miratojë bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të ngastrave të specifikuara, pa kompensim, në favor të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Mitrovica" Sh. A., për realizimin e projektit të furnizimit me ujë të pijshëm për Komunën e Leposaviqit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca 1

Lista e parcelave në pronësi publike për të cilat kërkohet e drejta e shfrytëzimit

Komuna e Leposaviqit

Nr.	Parcela nr.	Zona Kadastrale	Komuna	Pronari	Sipërfaqja
1	P-71308077-00280-0	Zonën Kadastrale Kutnje	Leposaviq	Agjencia Pyjore e Kosovës	Pyll i klasës V me sipërfaqe 4,249 m ² ;
2	P-71308077-00281-0	Zonën Kadastrale Kutnje	Leposaviq	Agjencia Pyjore e Kosovës	Tokë tjetër me sipërfaqe 3,868 m ² ;
3	P-71308077-00283-0	Zonën Kadastrale Kutnje	Leposaviq	Agjencia Pyjore e Kosovës	Kullotë e klasës V me sipërfaqe 34,434 m ² ;



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/29
Datë: 17.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 10/001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore, në vlerë prej 255,153.45€ (dyqind e pesëdhjetepesë mijë e njëqind e pesëdhjetetrec eurosh e dyzetepesë centë), për pajisjen me tekste mësimore në gjuhën shqipe, për nxënësit shqiptarë që vijnë në mësimin në gjuhën shqipe në Preshevë, në Bujanoc dhe në Medvegjë, për vitin shkollor 2025/2026.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përdoren mjetet nga organizata buxhetore "Zyra e Kryeministrit", me kod 104, nënprogrami "Përkrahje për Luginën e Preshevës", me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet, nga pika 1. e këtij Vendimi, do të transferohen në llogarinë bankare, të përcaktuar nga Këshilli Kombëtar Shqiptar.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/29
Datë: 17.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 10/001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të promovimit të vendit, ndahen mjetet financiare në shumë prej 40,000€ (dyzet mijë eurosh), për mbështetjen e organizimit dhe realizimit të ngjarjeve me karakter ndërkombëtar, në fushën e inovacionit, teknologjisë, ndërmarrësisë dhe transformimit digjital, të cilat kontribuojnë në promovimin e Republikës së Kosovës, forcimin e imazhit të saj ndërkombëtar dhe zhvillimin e ekosistemit vendor, si dhe në rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përmes organizimit të iniciativave dhe eventeve të njohura globale në këto fusha. Mjetet ndahen për organizatat, si në vijim:
 - 1.1. FLOSSK (Free Libre Open Source Software Kosova), ndahet shuma prej 20,000€ (njëzetë mijë eurosh); dhe
 - 1.2. ICK (Innovation Center Kosovo), ndahet shuma prej 20,000€ (njëzetë mijë eurosh).
2. Mjetet, nga pika 1. e këtij Vendimi, ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami "Programi për Promovim të Vendi" dhe barten në xhirollogarinë e organizatave respektive.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë